

VENDIM
Nr.794, datë 6.10.2010

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “TIRANA BUSINESS UNIVERSITY”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, 43, 44, 44/1 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Tirana Business University”, e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Administrim - Biznesit, që ofron programin e studimit të ciklit të parë, në fund të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor”, në “Administrim – biznesi”, në tri profile:

i) Menaxhim,

ii) Marketing,

iii) Kontabilitet - financë.

b) Fakulteti i të Drejtës së Biznesit, në fund të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “E drejta e biznesit”.

3. Shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha